



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2020:068701

Datë: 03.06.2021

Numri i dokumentit: 01848241

**P.nr.100/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja individuale Zajrete Muhaxheri me procesmbajtesen Indira Beqa në çeshtjen penale ndaj të pandehurit F.I nga fsh...-Kaçanik , per veprën penale ne vazhdim vjedhje pylli nga neni 349 par.3 nenpar.3.1 dhe 3.2 te KPRK-se , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.590/20 te dt.11 qershor 2020, aktakuzes PP.II.nr.703/20 te dt.10 gusht 2020 dhe aktakuzes PP.II.nr.1381/20 te dt.30 tetor 2020 , ne shqyrtimin fillestar te mbajtur me dt. 31 maj 2021 në prezencë të Prokurores se shtetit Albana Parduzi dhe të pandehurit , me dt.03 qershor 2021 mori dhe shpalli dhe te njejten date perpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri F.I nga fsh... Komuna Kacanik i lindur më dt... nga i ati N... dhe e ema Gj... e gjinisë V... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves , i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme,punëtor privat ndërtimtari , i gjendjes së dobët ekonomike,me nr.personal:..

**ESHTE FAJTOR**

I.Sepse me datë 12 shkurt 2020 rreth ores 13:00, ne territorin e Parkut Kometar “ ...”, njesia menagjuese Ahishta 2, ne vendin e quajtur “... “me qellim te vjedhjes, ka prere me sharre motorrike tri copë drunj te llojit te ahut, me diameter 24-27 cm, lartesi 17-18 m, dhe me vellim te pergjithshem prej 0.78 m<sup>3</sup>, te cilat I ka bartur me kali me qerre dy rroteshe, dhe me ketë veprim të demtues , DAPK- Sharri, I ka shkaktuar dem material ne vlere prej 273.00 € .

II.Sepse me dt. 07 mars 2020 rreth ores 11:30min. ne pyllin e mbrojtur , Parkun Kombetar “... “ Njesia Menaxhuese Ahishta, ne vendin e quajtur “...” Komuna Kacanik, I pandehuri me qellim vjedhje, me sharre motorrike ka prerë 2 trungje – drunj te llojit te ahut me diameter 26-33 cm, lartesi 18-21, dhe me vellim te pergjithshem 0,83 m<sup>3</sup>, te cilat I ka terhequr zvarrë me qerre kuajsh, me te cilin rast te demtues I eshte shkaktuar dem material ne vlere prej 268 €.

III.Sepse me date 17 korrik 2020 rreth ores 16:30 min., ne territorin e Parkut Kombetar, njesia menagjuese Ahishta 1, vendin e quajtur “...”, me qellim te vjedhjes, me sahrre motorrike ka prere 1 cope dru te llojit te ahut , me diameter.42 cm, lartesi 23 m, dhe me vellim te pergjithshem prej 1.04 m<sup>3</sup>, me te cilin rast te demtues AMMK-Prishtine I ka shkaktuar dem material ne vlere prej 312.00 €.

Me këto veprime i pandehuri ka kryer vepren penale vjedhje pyllit ne vazhdim nga neni 349 par.3 nenpar.3.1 dhe 3.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-se.

Prandaj gjykata në baze të nenit 2,3,38,43,69,70 të KPRK-se, dhe nenit 359,360,361 dhe 365 të KPP-se, e

## **G J Y K O N**

Me dënim me gjobë në shumë prej 250 € ( dyqind e pesëdhjetë euro) dhe me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 180 diteve.

I pandehuri eshte i obliguar qe denimin me gjobe t'a paguaje brenda afatit prej 15 ditesh, pasi qe ky aktgjykim te merr formën e prerë.

Nese i pandehuri nuk e paguan gjoben, gjykata do t'a zevendesoje denimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumen prej 20 € per çdo dite burgu.

Konfor nenit 45 par.1 te KPRK-se, denimi me burgim me pelqimin e te pandehurit, i zevendësohet me punë në dobi të përgjithshme në kohezgjatje prej 240 orëve.

I pandehuri eshte i obliguar qe punen ne dobi te pergjithshme t'a kryeje ne periudhen kohore ne kohëzgjatje prej 1 viti nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, ne te kundërtën gjykata do te urdheroje denimin me burgim ashtu që per çdo 8 ore pune do te llogaritet nje dite burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20,00 € në emër te paushallit gjyqësor ne afat te njëjtë me gjobën , nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri qe te dëmtuarës AMMK-Prishtine, t'i kompenzoje demin ne vlere prej 853.00 €.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.590/20 te dt.11 qershor 2020, aktakuzen PP.II.nr.703/20 te dates 10 gusht 2020, dhe aktakuzen PP.II.nr.1192/20 te dates 30 tetor 2020 te pandehurin F.I nga fsh...-Kaçanik e ka akuzuar për veprat penale, vjedhje pylli nga neni 349 par.3 nenpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së.

Ne baze te ketyre aktakuzave, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.31 maj 2021, me te cilin rast pas marrjes se pelqimit te paleve, gjykata beri bashkimin e lendeve te evidentuara pranë kësaj gjykate si lënda penale P.nr.100/20, P.nr.188/20 dhe P.nr.269/20 , e meqë lendet kane qene te natyrës dhe peshës se njejte , gjykata për hir te ekonomizimit te procedurës vendosi qe te zhvillohet procedure e përbashkët duke e udhëhequr procedurën sipas lendes P.nr.100/20.

Ne senacen e shqyrtimit fillestar prokurorja e shtetit Albana parduzy me rastin e prezentimit te aktakuzave, ka bere rikualifikimin juridik te vepres penale, nga veprat penale vjedhje pylli nga neni 349 par.3 nenpar.3.1 dhe 3.2 te KPRK-se, ne vepren penale vjedhje pylli ne vazhdim nga neni 349 par.3 nenpar.3.1 dhe 3.2 e lidhur me nenin 77 te KPRK-se .

I pandehuri pasi qe eshte njoftuar nga gjykata per rikualifikimin juridik te aktakuzes, në fjalen e tij ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajesine per veprën penale per te cilën akuzohet, eshte arsyetuar se keto dru ka patur per qellim qe t’I shfrytzoje per nevojat e e konomise familjare, dhe ka premtuar para gjykates se veprime te tilla nuk do te perserise ne te ardhmen, duke kerkuar nga gjykata nje denim sa me te ulet qe te jete e mundur, mundesisht demin me pune ne dobi te pergjithshme.

Prokurori I shtetit ne fjalen e tij eshte dakorduar me pranimin e fajesise nga ana e te pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 248 të KPK pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajesisë, se pranimi i fajesise është bërë vullnetarisht , se pranimi i fajit mbeshtetet ne faktet e çeshtjes qe permban akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qarte ligjore apo gabime teknike.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen te gjitha tiparet e veprës penale vjedhje pylli ne vazhdim, nga neni 349 par. 3 nenpar.3.1 dhe 3.2 lidhur me nenin 77 te KPRK-së.

Me rastin e caktimit te dënimit gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese konform nenit 70 te KPRK-se, kështu qe si rrethane lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajesine per veprën penale per te cilen e ngarkon aktakuza ne shqyrtim fillestar, nuk ka nje marredhenie te rregullt pune dhe rrjedhimisht nuk jeton ne kushte te mira ekonomike, mosha e tij e re ne kohen e kryerjes se veprave penale, ndërsa si rrethanë te posaçme renduese gjykata nuk gjeti pos veprimeve te pandehurit te cilat paraqesin tiparet e veprës penale për te cilën eshte shpallur fajtor.

Andaj, për këto arsye gjykata te pandehurit, për veprën penale vjedhje pylli ne vazhdim nga neni 349 par. 3 nenpar.3.1 dhe 3.2 lidhur me nenin 77 te KPRK-se, e gjykoi me denim te precizuar si në dispozitiv të ketij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do te ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë qe te mos kryejnë vepra te tilla penale dhe se me ketë do te arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i parapare ne nenin 38 te KPRK-se.

Vendimi për shpenzimet e procedures është i bazuar në dispozitën e nenit 450 par 2 të KPP-se.  
Vendimi per kerkesen pasurore juridike u mor konfor nenit 463 te KPP-se .

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**P. nr. 100/20 datë 03.06.2021**

Procesmbajtesja,  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.